

Divine Helps for Mortality

By President Dallin H. Oaks
First Counselor in the First Presidency

Ndihmat Hyjnore për Vdekshmërinë

Nga Presidenti Dallin H. Oaks,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

April 2025 general conference

Our Heavenly Father's plan provides helps to guide us through our mortal journeys.

Plani i Atit tonë Qiellor na siguron ndihma për të na udhërrëfyer përgjatë rrugëtimeve tona në vdekshmëri.

I.

Through the Prophet Joseph Smith, the Lord revealed a few things about our pre-earth life. There we existed as spirit children of God. Because God desired to help His children progress, He decided to create an earth on which we could receive a body, learn through experience, develop divine attributes, and be proven to see if we would keep God's commandments. Those who qualified would "have glory added upon their heads for ever and ever" (Abraham 3:26).

To establish the conditions of this divine plan, God chose His Only Begotten Son to be our Savior. Lucifer, whose suggested alternative would destroy the agency of man, became Satan and was "cast down." Banished to the earth and denied the privilege of mortal life, Satan was permitted to attempt "to deceive and to blind men, and to lead them captive at his will, even as many as would not hearken unto [God's] voice" (Moses 4:4).

Essential to God's great plan for the mortal growth of His children was for them to experience "opposition in all things" (2 Nephi 2:11). Just as our physical muscles cannot be developed or maintained without straining against the law of gravity, so mortal growth requires us to strain against Satan's temptations and other mortal

I.

Nëpërmjet Profetit Jozef Smith, Zoti na zbuloi disa gjëra rreth jetës sonë paratokësore. Atje ekzistonim si fëmijë shpirtërorë të Perëndisë. Ngaqë Perëndia dëshironte t'i ndihmonte fëmijët e Tij të përparonin, Ai vendosi të krijonte një tokë, në të cilën të mund të merrnim një trup, të mësonim nëpërmjet përvojës, të zhvillonim tipare hyjnore dhe të viheshim në provë për të parë a do t'i zbatonim urdhërimet e Perëndisë. Ata që kualifikoheshin, do të kishin "lavdi të shtuar mbi kokat e tyre përherë e përgjithmonë" (Abraham 3:26).

Për të krijuar kushtet për këtë plan hyjnor, Perëndia zgjodhi Birin e Tij të Vetëmlindur që të ishte Shpëtimtari ynë. Luciferi, alternativa e sugjeruar e të cilit do të shkatërronte lirinë e zgjedhjes së njeriut, u bë Satani dhe u "flak... tutje". I dëbuar në tokë dhe pa privilegjin e jetës në vdekshmëri, e cila iu mohua, Satanit iu lejua që të përpiqej "për të mashtruar e verbuar njerëzit dhe për t'i çuar ata në robërinë e vullnetit të tij, madje të gjithë ata që nuk do t'i bindeshin zërit [të Perëndisë]" (Moisiu 4:4).

Thelbësore ndaj planit të madhërishtëm të Perëndisë për rritjen [e karakterit] të fëmijëve të Tij në vdekshmëri, ishte që ata të përjetonin "kundërshtim në të gjitha gjërat" (2 Nefi 2:11). Ashtu si muskujt tanë fizikë nuk mund të zhvillohen ose ruhen pa rezistuar kundrejt ligjit të rëndësës, po ashtu rritja [në karakter] gjatë

opposition. Most important for spiritual growth is the requirement to choose between good and evil. Those who choose good would progress toward their eternal destiny. Those who choose evil—as all would do in the various temptations of mortality—would need saving help, which a loving God designed to provide.

II.

By far, God's strongest mortal help was His provision of a Savior, Jesus Christ, who would suffer to pay the price and provide forgiveness for repented sins. That merciful and glorious Atonement explains why faith in the Lord Jesus Christ is the first principle of the gospel. His Atonement "bringeth to pass the resurrection of the dead" (Alma 42:23), and it "atone[s] for the sins of the world" (Alma 34:8), erasing all of our repented sins and giving our Savior power to succor us in our mortal infirmities.

Beyond that glorious erasing of sins committed and being forgiven, the plan of a loving Father in Heaven provides many other gifts to protect us, including protecting us from sinning in the first place. Our mortal life always begins with a father and a mother. Ideally, both are present, with different gifts to guide our growth. If not, their absence is part of the opposition we must overcome.

III.

Our Heavenly Father's plan provides other helps to guide us through our mortal journeys. I will speak of four of these. Please don't hold me to my number offour, because these helps are overlapping. Moreover, there are other merciful protections in addition to these.

First, I speak of the Light or Spirit of Christ. In his great teaching in the book of Moroni, Moroni quotes his father that "the Spirit of Christ is given to every man, that he may know good from evil" (Moroni 7:16). We read this same teaching in modern revelations:

vdekshmërisë kërkon që ne t'u rezistojmë tundimeve të Satanit dhe kundërshtimeve të tjera në vdekshmëri. Më e rëndësishmja për rritjen shpirtërore është kërkesa për të zgjedhur midis së mirës dhe së keqes. Ata që zgjidhnin të mirën, do të përparonin drejt fatit të tyre të përjetshëm. Ata që zgjidhnin të keqen, sikurse të gjithë do të bënin në tundimet e ndryshme në vdekshmëri, do të kishin nevojë për ndihmë shpëtuese, të cilën një Perëndi i dashur e projektoi dhe na e siguroi.

II.

Pa dyshim, ndihma më e fuqishme e Perëndisë në vdekshmëri ishte sigurimi nga ana e Tij e një Shpëtimtari, Jezu Krishtit, i cili do të vuante për të paguar çmimin dhe siguruar falje për mëkatet për të cilat pendohemi. Ajo Shlyerja e mëshirshme dhe e lavdishme shpjegon arsyen përse besimi te Zoti Jezu Krisht është parimi i parë i ungjillit. Shlyerja e Tij "shkakton ringjalljen e të vdekurve" (Alma 42:23) dhe ajo "shlye[n] për mëkatet e botës" (Alma 34:8), duke i fshirë të gjitha mëkatet tona për të cilat jemi penduar, dhe duke i dhënë Shpëtimtarit tonë fuqi për të na ndihmuar në dobësitë tona në vdekshmëri.

Përtej asaj fshirjeje të lavdishme të mëkatëve të kryera dhe që janë falur, plani i një Ati të dashur në Qiell siguron shumë dhurata të tjera për të na mbrojtur, përfshirë mbrojtjen tonë nga kryerja e mëkatit që në fillësë. Jeta jonë në vdekshmëri gjithmonë fillon me një baba dhe një nënë. Idealja do të ishte që të dy të jenë të pranishëm, me dhunti të ndryshme për të na udhërrëfyer gjatë rritjes. Nëse jo, mungesa e tyre është pjesë e kundërshtimit që duhet ta kapërcejmë.

III.

Plani i Atit tonë Qjellor na siguron ndihma të tjera për të na udhërrëfyer përgjatë rrugëtimit tona në vdekshmëri. Unë do të flas për katër prej tyre. Mos më kërkon t'i përmbahem tëkatërtave, pasi këto ndihma ndërlidhen me njëra-tjetrën. Për më tepër, ka mbrojtje të tjera të mëshirshme përveç këtyre.

Së pari, flas për Dritën ose Shpirtin e Krishtit. Moroni, te mësimi i tij i shkëlqyer në Librin e Moronit, citon atin e tij se "Shpirti i Krishtit i jepet çdo njeriu, që ai të dallojë të mirën nga e keqja" (Moroni 7:16). Ne e lexojmë po të njëjtin mësim në zbulesat moderne:

“And the Spirit giveth light to every man that cometh into the world; and the Spirit enlighteneth every man through the world, that hearkeneth to the voice of the Spirit” (Doctrine and Covenants 84:46).

Again: “For my Spirit is sent forth into the world to enlighten the humble and contrite, and to the condemnation of the ungodly” (Doctrine and Covenants 136:33).

President Joseph Fielding Smith explained these scriptures: “The Lord has not left men (when they are born into this world) helpless, groping to find the light and truth, but every man ... is born with the right to receive the guidance, the instruction, the counsel of the Spirit of Christ, or Light of Truth.”

Thesecondof the great assistances provided by the Lord to help us choose what is right is a cluster of divine directions in the scriptures as part of the plan of salvation (plan of happiness). These directions are commandments, ordinances, and covenants.

Commandmentsdefine the path our Heavenly Father has marked out for us to progress toward eternal life. People who imagine commandments as the way God decides who to punish fail to understand this purpose of God’s loving plan of happiness. On that path, we can gradually achieve the needed relationship with our Savior and qualify for an increase of His power to help us on our way to the destination He desires for all of us. Our Heavenly Father desires all of His children to return to the celestial kingdom, where God and our Savior reside, and to have the kind of life of those who reside in that celestial glory.

Ordinancesandcovenantsare part of the law that defines the path to eternal life. Ordinances, and the sacred covenants we make with God through them, are required steps and essential guardrails along that path. I like to think of the role of covenants as demonstrating that under God’s plan, His highest blessings are given to those who promise in advance to keep certain commandments and who keep those promises.

Other God-given helps for making right choices are the manifestationsof the Holy Ghost. The Holy Ghost is the third member of the

“Dhe Shpirti i jep dritë çdo njeriu që vjen në botë; dhe Shpirti ndriçon çdo njeri në botë, që i bindet zërit të Shpirtit” (Doktrina e Besëlidhje 84:46).

Përsëri: “Sepse Shpirti im i dërgohet botës për ta ndriçuar të përlulur e të penduarin dhe për ndëshkimin e të paperëndishmëve” (Doktrina e Besëlidhje 136:33).

Presidenti Jozef Filding Smith i shpjegoi këto shkrime të shenjta: “Zoti nuk i ka lënë njerëzit (kur ata linden në këtë botë) të pashpresë, duke u përpjekur verbazi që të gjejnë dritën dhe të vërtetën, por çdo njeri ... lindet me të drejtën për të marrë udhërrëfimin, udhëzimin, këshillën e Shpirtit të Krishtit ose Dritës të së Vërtetës”.

Edytanga ndihmat e madhërishme, të siguruara nga Zoti për të na ndihmuar që të zgjedhim atë që është e drejtë, është një grumbull udhëzimesh hyjnore në shkrimet e shenjta si pjesë e planit të shpëtimit (planit të lumturisë). Këto udhëzime janë urdhërimet, ordinancat dhe besëlidhjet.

Urdhërimetpërcaktojnë shtegun që Ati ynë Qiellor e ka shenjuar për ne që të përparojmë drejt jetës së përjetshme. Njerëzit që i përfytyrojnë urdhërimet si mënyrën se si Perëndia vendos se kë të ndëshkojë, nuk arrijnë që ta kuptojnë këtë qëllim të planit të dashur të Perëndisë për lumturinë. Në atë shteg, dalëngadalë ne mund ta arrijmë marrëdhënien e nevojshme me Shpëtimtarin tonë dhe të kualifikohemi për një rritje të fuqisë së Tij për të na ndihmuar në udhën tonë drejt fatit që Ai dëshiron për ne të gjithë. Ati ynë Qiellor dëshiron që të gjithë fëmijët e Tij të kthehen në mbretërinë çelestiale, ku banojnë Perëndia dhe Shpëtimtari ynë, dhe të kenë atë lloj jete si ata që banojnë në atë mbretëri çelestiale.

Ordinancatdhebesëlidhjetjanë pjesë e ligjit që përcakton shtegun drejt jetës së përjetshme. Ordinancat, si dhe besëlidhjet e shenjta që i bëjmë me Perëndinë nëpërmjet tyre, janë hapat e kërkuar dhe parmakët thelbësorë mbrojtës përgjatë atij shtegu. Më pëlqen të mendoj për rolin e besëlidhjeve sikurse demonstrohet që sipas planit të Perëndisë, bekimet e Tij më të larta u jepen atyre që premtojnë që më parë për t’i zbatuar urdhërime të caktuara dhe të cilët i mbajnë ato premtime.

Ndihma të tjera të dhëna nga Perëndia për bërjen e zgjedhjeve të drejta janëshfaqjet e Frymës së Shenjtë. Fryma e Shenjtë është anëtare

Godhead. His function, defined in scripture, is to testify of the Father and the Son, to teach us, to bring all things to our remembrance, and to guide us into all truth. The scriptures include many descriptions of the manifestations of the Holy Ghost, such as a spiritual witness in response to an inquiry about the truth of the Book of Mormon. A manifestation is not to be confused with the gift of the Holy Ghost, which is conferred following baptism.

One of the most significant of God's helps for His faithful children is the gift of the Holy Ghost. The importance of this gift is evident in the fact that it is formally conferred after repentance and baptism by water, "and then [the scriptures explain] cometh a remission of your sins by fire and by the Holy Ghost" (2 Nephi 31:17). Persons who have this remission of sins—and then regularly renew their cleansing by daily repentance and living according to the covenants they make through the ordinance of the sacrament—qualify for the promise that the Holy Ghost, the Spirit of the Lord, "may always ... be with them" (Doctrine and Covenants 20:77).

Thus, President Joseph F. Smith taught that the Holy Ghost will "enlighten the minds of the people with regard to the things of God, to convince them at the time of their conversion of their having done the will of the Father, and to be in them an abiding testimony as a companion through life, acting as the sure and safe guide into all truth and filling them day by day with joy and gladness, with a disposition to do good to all men, to suffer wrong rather than to do wrong, to be kind and merciful, long suffering and charitable. All who possess this inestimable gift, this pearl of great price, have a continual thirst after righteousness. Without the aid of the Holy Spirit," President Smith concluded, "no mortal can walk in the straight and narrow way."

IV.

With so many powerful helps to guide us in our mortal journeys, it is disappointing that so many remain unprepared for their appointed meeting with our Savior and Redeemer, Jesus Christ. His parable of the ten virgins, spoken of

i tretë i Kreut-Perëndi. Funksioni i Tij, i përcaktuar në shkrimin e shenjtë, është që të dëshmojë për Atin dhe Birin, të na mësojë, të na kujtojë të gjitha gjërat dhe të na prijë drejt çdo të vërtete. Shkrimet e shenjta përfshijnë shumë përshkrime për shfaqjet e Frymës së Shenjtë, të tilla si një dëshmim shpirtëror në përgjigje ndaj një kërkesë rreth së vërtetës së Librit të Mormonit. Një shfaqje nuk duhet të ngatërrohet me dhuratën e Frymës së Shenjtë, e cila jepet pas pagëzimit.

Një nga ndihmat më domethënëse të Perëndisë për fëmijët e Tij besnikë, është dhurata e Frymës së Shenjtë. Rëndësia e kësaj dhurate është e dukshme në faktin që ajo, në mënyrë formale, jepet pas pendimit dhe pagëzimit me ujë "dhe pastaj [shpjegojnë shkrimet e shenjta] vjen një heqje e mëkateve tuaja me anë të zjarrit dhe me anë të Frymës së Shenjtë" (2 Nefi 31:17). Njerëzit që e kanë këtë heqje të mëkateve, dhe më pas rregullisht e përtërijnë pastrimin e tyre nëpërmjet pendimit të përditshëm dhe të jetuarit sipas besëlidhjeve që bëjnë nëpërmjet ordinancës së sakramentit, kualifikohen për premtimin se Fryma e Shenjtë, Shpirti i Zotit, "mund të [jetë] gjithmonë ... me ta" (Doktrina e Besëlidhje 20:77).

Kështu, Presidenti Jozef F. Smith dha mësim se Fryma e Shenjtë do të "ndriçojë mendjet e njerëzve në lidhje me gjërat e Perëndisë, për t'i bindur në kohën e kthimit të tyre në besim se kanë bërë vullnetin e Atit dhe për të qenë brenda tyre një dëshmi e qëndrueshme si një shoqërues gjatë gjithë jetës, duke vepruar si udhërrëfyesi i sigurt dhe i palëkundshëm drejt çdo të vërtete dhe duke i mbushur ata ditë pas dite me gëzim e lumturi, me një prirje për të bërë mirë ndaj gjithë njerëzve, për të vuajtur të padrejtën në vend që të bëjnë të padrejtën, për të qenë të mirë e të mëshirshëm, të duruar e dashamirës. Të gjithë që e zotërojnë këtë dhuratë të paçmuar, këtë perle me vlerë të madhe, kanë një etje të vazhdueshme për drejtësinë. Pa ndihmën e Shpirtit të Shenjtë", e mbylli Presidenti Smith "asnjë njeri i vdekshëm nuk mund të ecë në udhën e ngushtë e të ngushtuar."

IV.

Me kaq shumë ndihma të fuqishme për të na udhërrëfyer në rrugëtimet tona në vdekshmëri, është zhgënjyese që kaq shumë njerëz mbeten të papërgatitur për takimin e tyre të caktuar me Shpëtimtarin dhe Shëlbuesin tonë, Jezu Krishtin.

so frequently in this conference, suggests that of those invited to meet Him, only half will be prepared.

We all know examples of the unprepared: returned missionaries who have interrupted their spiritual growth by periods of inactivity, youth who have jeopardized their spiritual growth by separating themselves from Church teaching and activities, men who have postponed their ordination to the Melchizedek Priesthood, men and women—sometimes the posterity of noble pioneers or worthy parents—who have departed the covenant path short of making and keeping covenants in the holy temple.

Many of such deviations occur when members fail to follow the fundamental spiritual maintenance plan of personal prayer, regular scripture study, and frequent repentance. In contrast, some neglect weekly renewal of covenants by not partaking of the sacrament. Some say the Church is not meeting their needs; those substitute what they perceive as their future needs ahead of what the Lord has provided in His many teachings and opportunities for our essential service to others.

Humility and trust in the Lord are the remedies for such deviations. As the Book of Mormon teaches, the Lord “doth bless and prosper those who put their trust in him” (Helaman 12:1). Trusting in the Lord is a particular need for all who wrongly measure the commandments of God and the teachings of His prophets against the latest findings and wisdom of man.

I have spoken of the many mortal helps our loving Father in Heaven has given to help His children return to Him. Our part in this divine plan is to trust in God and seek and use these divine helps, most notably the Atonement of His Beloved Son, our Savior and Redeemer, Jesus Christ. I pray that we will teach and live these principles, in the name of Jesus Christ, amen.

Shëmbëlltyra e Tij për dhjetë virgjëreshat, e përmendur aq shpesh në këtë konferencë, sugjeron se nga njerëzit që ftohen të takohen me Të, vetëm gjysma do të jenë të përgatitur.

Ne të gjithë dimë shembuj të të papërgatiturve: misionarë të kthyer nga misionet që e kanë ndërprerë rritjen e tyre shpirtërore si rrjedhojë e periudhave e të mos qenit aktivë, të rinj e të reja që e kanë vënë në rrezik rritjen e tyre shpirtërore duke u ndarë nga mësimdhënia dhe veprimtaritë e Kishës, burra që e kanë shtyrë shugurimin e tyre në Priftërinë Melkizedeke, burra dhe gra, nganjëherë pasardhës të pionierëve fisnikë ose prindërve të denjë, të cilët janë larguar nga shtegu i besëlidhjeve duke zgjedhur të mos i bëjnë e mbajnë besëlidhjet në tempullin e shenjtë.

Shumë prej devijimeve të tilla ndodhin kur anëtarët dështojnë në ndjekjen e planit themelor të mirëmbajtjes shpirtërore që përfshin lutjen vetjake, studimin e rregullt të shkrimeve të shenjta dhe pendimin e shpeshtë. Në dallim, disa e lënë pas dore ripërtëritjen e përjavshme të besëlidhjeve duke mos e marrë sakramentin. Disa thonë se Kisha nuk po i përmbush nevojat e tyre. Këta njerëz kanë përparësi ato çfarë ata perceptojnë si nevojat e tyre të ardhshme dhe jo ato që Zoti ka siguruar në mësimet e Tij të shumta dhe mundësitë për shërbimin tonë thelbësor ndaj të tjerëve.

Përlësia dhe mirëbesimi te Zoti janë ilaçet për devijime të tilla. Siç na mëson Libri i Mormonit, Zoti i “bekon dhe i përparon [vërtet] ata që e vendosin besimin e tyre në Të” (Helamani 12:1). Mirëbesimi te Zoti është një nevojë e posaçme për të gjithë ata që në mënyrë të gabuar i matin urdhërimet e Perëndisë dhe mësimet e profetëve të Tij me gjetjet më të fundit dhe urtësinë e njeriut.

Kam folur për ndihmat e shumta në vdekshmëri që Ati ynë i dashur në Qiell i ka dhënë për t'i ndihmuar fëmijët e Tij që të kthehen tek Ai. Roli ynë në këtë plan hyjnor është të mirëbesojmë te Perëndia dhe t'i kërkojmë e t'i përdorim këto ndihma hyjnore dhe, më veçanërisht nga të gjitha, Shlyerjen e Birit të Tij të Dashur, Shpëtimtarit dhe Shëlbuesit tonë, Jezu Krishtit. Unë lutem që ne do t'i japim mësim dhe do t'i jetojmë këto parime, në emrin e Jezu Krishtit, amen.